

VENDIM
Nr. 773, datë 5.9.2013

**PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 515, DATË 18.7.2003 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE
TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8 pika 3, 10 e 12 të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Bashkëlidhet lista shtesë e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes, me numrat rendorë 24/1, 97/1, 97/2, 1019/1, 974/1, 696/1, 958/1 dhe 1193 (një mijë e njëqind e nëntëdhjetë e tre) – 1219 (një mijë e dyqind e nëntëmbëdhjetë).

b) Në listën bashkëlidhur vendimit, përmasat e pronave zëvendësohen me përmasat e përcaktuara në formularët bashkëlidhur këtij vendimi.

Lista përbëhet gjithsej nga 63 (gjashtëdhjetë e tre) fletë.

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, Ministri i Mbrojtjes dhe Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha